

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 12

(Korrik- Dhjetor 2022)

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE.....	4
1.Vendim nr.318, datë 04.10.2022	4
2.Vendim nr.32, datë 14.09.2022	7
3.Vendim Nr.3009, Date 14.11.2022.....	10
4.Vendim Nr.2906, Date 24.10.2022.....	12
5. Vendim Nr.291 Datë 14.09.2022.....	13
6. Vendim Nr.374, datë 19.10.2022	16
7. Vendim Nr. 434, datë 26.10.2022	18
8. Vendim nr. 368, datë 12.10.2022	20
9. Vendim nr. 596, datë 07.12.2022	22
10. Vendim Nr.331, datë 05.10.2022	25
11.Vendim Nr. 306, datë 21.09.2022	27
12.Vendim Nr.472, datë 06.07.2022	29

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjashtë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në faqen legjislacionin, në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c//legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1. Vendim nr.318, datë 04.10.2022

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës : Shoqëria “V.D” sh.p.k

Të paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Apelimit Tatimor
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Objekti : shfuqizimin e njoftim vlerësimit për detyrimin tatimor nr.____ Prot., datë 05.09.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr.____ Prot., datë 26.12.2014, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Baza ligjore : Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 119, Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.23, datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit :

Shoqëria “V.D” sh.p.k, është subjekt në administrim të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt aktiviteti “tregtim karburant, vajra lubrifikantë, import-eksport.....”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, i ka komunikuar subjektit njoftim-vlerësimin nr.____ Prot., datë 05.09.2014, sipas të cilit subjekti është penalizuar me gjobë në vlerën 500.000 lekë, bazuar në nenin 119 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008, i ndryshuar, për mosdeklarim punonjësi, për periudhën tatimore 2014/03.

Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor, me një kërkesë ankimore në lidhje me këtë vlerësim.

Kjo Drejtori nëpërmjet Vendimit nr. ____ Prot., datë 26.12.2014, ka vendosur *Lëniën në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore nr.____Prot., datë 05.09.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.*

Në zbatim të Urdhrit të punës nr.____ Prot., datë 17.03.2014, Grupi i punës së Administratës Tatimore ka ushtruar kontroll pranë subjektit tatimpagues Shoqëria “V.D” sh.p.k me datën 17.03.2014.

Në bazë të kontrollit apo verifikimit të kryer nga grupi i punës është mbajtur Akt konstatimi me numër serie _____, datë 17.03.2014.

Akti i konstatimit rezulton të jetë nënshkruar nga personi i gjendur në punë z. M.D, duke pranuar në këtë mënyrë dhe të gjitha faktet e konstatuara nga grupi i kontrollit apo verifikimit të bërë.

Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, mbi bazën e informacionit të marrë ka bërë verifikimin e të gjithë punonjësve të deklaruar si “*të punësuar*” nga subjekti Shoqëria “V.D” sh.p.k.

Në vijim, Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave dhe Kontabilitetit, me shkresën nr.____ Prot., datë 13.08.2014, njofton Drejtorinë e Kontrollit Tatimor se punonjësi i konstatuar në punë z.M.D, në bazë

të Akt konstatimit me numër serie _____, datë 17.03.2014 është deklaruar nga Shoqëria “V.D” sh.p.k para organit tatimor me datën 17.03.2014, pra ditën e mbajtjes së Aktit të konstatimit, deklarim i bërë sipas Formularit “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi dhe e të larguarve nga puna Formulari E-SIG 027/a”.

Në bazë të praktikës hetimore administrative të ndjekur, është vlerësuar se punonjësi i gjendur në punë, z.M.D, nuk është deklaruar në organin tatimor nga subjekti brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Verifikimi është bërë referuar periudhës tatimore kur është gjendur në punë.

Para Gjykatës është paraqitur me vlerën e provës Formulari “Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi dhe e të larguarve nga puna formulary E-SIG 027/a”, deklaruar nga subjekti para organit tatimor datë 17.03.2014 dhe nëpërmjet këtij formulari subjekti ka deklaruar si datë fillimi pune për z.M.D, datën 18.03.2014, pra pas datës së mbajtjes së Akt konstatimit dhe jashtë afatit ligjor.

Pas verifikimeve të kryera dhe në sistemin informatik tatimor në lidhje me deklarimin e të punësuarve rishtazi nga subjekti i kontrolluar, pra pas një hetimi të plotë administrativ është proceduar pranë subjektit me komunikimin e shkeljes duke u paraqitur dhe një herë pranë tij dhe mbajtur Procesverbalin e gjobës por mbi bazën e konstatimit të kryer, pasqyruar të dhënat në Akt konstatimin me numër serie _____, datë 17.03.2014.

Vlerësimi i gjobës është bazuar në nenin 119, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Arsyetimi ligjor i Gjykatës :

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.____, datë 15.09.2016, nëpërmjet të cilit vendosi:

- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me shkresën nr.____ prot, datë 05.09.2014, të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, i lënë në fuqi nga Drejtoria e Apelit Tatimor me shkresën nr.____ prot, datë 26.12.2014, që ka njoftuar detyrime tatimore për palën paditëse subjektin Shoqëria “V.D” sh.p.k.*
- *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, që të heqë këtë detyrim tatimor nga dosja e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit subjektit Shoqëria “V.D” sh.p.k...*

Mbi bazën e kërkesës ankimore të palës së paditur, çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka çmuar se vendimi nr.____, datë 15.09.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe për rrjedhojë ai duhet të ndryshohet dhe padia duhet të rrëzohet.

Gjykata bazon arsyetimin e saj në interpretimin e normave që rregullonin në kohën e daljes së aktit që kundërshtohet gjyqësisht, konceptin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ si një nga format e veprimit administrativ. Konkretisht bëhet fjalë për nenin 116 të K.Pr.Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Përveçse një referimi të përgjithshëm në dispozitat e këtij Kodi nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë përmendet edhe fakti, se aktet administrative nuk i janë njoftuar palës paditëse.

Në këtë rast, nëse merret i mirëqenë ky arsyetim si shpjegohet fakti që pala paditëse ka venë në lëvizje fillimisht nëpërmjet ankimit administrativ Drejtorinë e Apelit Tatimor dhe mandej Gjykatën. Në këtë kuptim edhe ky arsyetim i gjykatës së shkallës së parë nuk qëndron. Për më tepër në të gjithë qëndrimin e saj në padi por edhe në gjykim, pala paditëse ka kërkuar shfuqizimin e akteve administrative dhe ka pretenduar pavlefshmërinë e tyre relative.

Pala paditëse ngre pretendimi se shtetasi MD është i biri i tatimpagueses dhe se për këtë të fundit nuk ka pasur detyrim për regjistrimin si punëmarrës. Në këtë rast pala paditëse nuk tregon, se cila është dispozita ligjore në kohën e konstatimit që ligjëron mosregjistrimin e familjareve si të punësuar në organet tatimore. Për më tepër në rastin konkret punëdhënës rezulton një person juridik shoqëri tregtare dhe jo një person fizik.

Ndaj këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit nuk lejohet rekurs, pasi vlera e padisë është nën kufirin minimal të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit nr.49/2012.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit :

- *Ndryshimin e vendimit nr.____, datë 15.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

2. Vendim nr.32, datë 14.09.2022

Gjykata Administrative e Apelit

Kërkues : Shoqëria “A” sh.p.k

Person i Tretë : Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër;
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Objekti : “1.Marrjen e masës së përkohshme, pezullimin e kryerjes së veprimeve administrative për zbatimin e mëtejshëm të Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurisë të dhënë nga Drejtoria e mbledhjes së borxhit, pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, me nr.____ Prot., datë 30.05.2016, deri në përfundim të procedurës administrative nga Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë apo çdo mase tjetër që të çmojë të arsyeshme Gjykata.

2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së tretë”

Baza ligjore:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.6, datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit :

Kërkuesi, Shoqëria “A” sh.p.k është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt aktiviteti “Ndërtimin e objekteve të ndryshme, tregtimin me shumicë e pakicë ...”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ka adresuar për shoqërinë “A” sh.p.k, aktin nr.____ Prot., datë 30.05.2016, “Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e Barrës Hipotekore dhe Siguruese”, si një akt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

Administrata tatimore i ka dërguar subjektit në fjalë “njoftim për pagimin e detyrimit”, që nuk është paguar, prandaj në vijim detyrimet janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me nenin 91 të Ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në këtë akt pasqyrohen detyrimet e papaguara nga subjekti sipas zërave tatimorë, detyrim, gjobë, interes dhe Borxhi gjithsej në vlerën x lekë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër është njoftuar në lidhje me çështjen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër vetëm me vendim, protokolluar pranë saj me nr.____ Prot., datë 08.08.2016.

Arsyetimi ligjor i Gjykatës :

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.____, datë 26.07.2016, nëpërmjet të cilit vendosi :

- *Mospranimin e kërkesës në çështjen e veçantë administrative që është ngritur nga pala kërkuese Shoqëria “A” sh.p.k, pasi kërkesa nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj;*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese Shoqëria “A” sh.p.k.....*

Sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, pala kërkuese ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesë duke pretenduar sipas objektit të mësipërm duke paraqitur para gjykatës kërkesën e mësipërme dhe duke i bashkëngjitur asaj aktet përkatëse, por jo akte për atë çfarë kërkohet në objektin e kërimit. Kërkesa e paraqitur për llogari të palës kërkuese është nënshkruar nga përfaqësuesja (avokatja), pa tagër përfaqësimi duke i hequr mundësinë gjykatës për ta marrë në shqyrtim.

Kërkesës së paraqitur para gjykatës në lidhje me tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe së drejtës mbi të cilën mbështetet kërkesa, nuk i është vënë vetë padia, në kuptimin që kërkesa nuk ka të pasqyruar padinë për të cilën kërkohet sigurimi i saj.

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave të sigurimit të padisë, pezullimin e kryerjes së veprimeve administrative për zbatimin e mëtejshëm të Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurisë të dhënë nga Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër me nr.____Prot., datë 30.05.2016, deri në përfundim të procedurës administrative nga Drejtoria e Apelit Tatimor apo çdo masë tjetër që ta çmojë të arsyeshme Gjykata.

Në seancë pala kërkuese nuk ka paraqitur prova për të mbështetur kërkesën e saj, por vetëm sa kërkohet në objektin e kërkesës.

Nisur nga gjendja e akteve, Gjykata konstatoi se, kërkesapadia nuk plotëson kushtet e neneve të Kreut IV të Ligjit nr.49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar.

Gjykata çmoi se, duhet të vendosë mospranimin e kërkesëspadisë, pasi ajo nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.32, datë 14.09.2022, vendosi:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.____, datë 26.07.2016, të Gjykatës Administrative të*

Shkallës së Parë Shkodër.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson ndër të tjera, se shkaqet e ankimit të veçantë të palës kërkuese “A” sh.p.k nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj. Për rrjedhojë vendimi nr.____, datë 26.07.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet të lihet në fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit konstaton se, pala kërkuese “A” sh.p.k ka paraqitur në gjykatë kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë përpara ngritjes së padisë, për njoftimin e tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurisë nr.____ Prot., datë 30.05.2016, të personit të tretë Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Gjykata Administrative e Apelit vlerësoi se kërkimi i palës kërkuese “A” sh.p.k nuk gjen mbështetje në ligjin e posaçëm të zbatueshëm në fushën e mbledhjes së detyrimeve tatimore nga organi tatimor.

Pala kërkuese nuk i ka provuar gjykatës as plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 29 të Ligjit nr.49/2012, i ndryshuar.

Gjykata çmon se dëmi nuk është i atëçastshëm edhe për shkak të kohës relativisht të gjatë që ka kaluar nga data e daljes së aktit administrativ (datë 30.05.2016) deri në momentin e depozitimit të kërkesës për sigurim padie pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Gjithashtu, pala kërkuese i ka të gjitha mundësitë ligjore që të kompensohet për çdo dëm potencial që mund t'i vijë si pasojë e ekzekutimit të aktit administrativ nëse konstatohet se dëmi është rezultat i aktit të paligjshëm të organit administrativ.

Në lidhje me cënimin e interesit public, Gjykata vlerëson se pezullimi i zbatimit të aktit administrativ për njoftimin e tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe sigurisë, nr.____Prot., datë 30.05.2016, të personit të tretë Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, shkakton mungesë të efikasitetit të organit administrativ, i cili ka për objekt të veprimtarisë së tij mbledhjen e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

Për këto arsye, bazuar në vlerësimin dhe arsyetimin e parashtruar më sipër në këtë vendim lidhur me ligjin e zbatueshem dhe faktet e pranuar në gjykim, Gjykata Administrative e Apelit arriti në përfundimin se, shkaqet e paraqitura në ankimin e veçantë të palës kërkuese "A" sh.p.k janë të pambështetura në ligj.

Për rrjedhojë vendimi nr.____, datë 26.07.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet të lihet në fuqi.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.____, datë 26.07.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*

3. Vendim Nr.3009, Date 14.11.2022

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Paditës : Shoqëria “E” shpk

I paditur: Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane

Objekti: 1-Shfuqizimin e vendimit nr. __ prot., dt.29.06.2022 të Drejtorisë së Apelit Tatimor
2-Shfuqizimin e njoftim vlerësimit tatimor nr. __ prot., dt.20.01.2022 për gjobë në vlerë x lekë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Baza Ligjore :

1. Neni 131 dhe 132 “Kodi Procedurave Administrative”.
2. Ligji nr.9920, dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria “E” shpk, me NIPT Y është në administrim të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me objekt aktiviteti “Furnizimi i ëbsite-ve, ëeb-hosting, mirëmbajtjes në distancë të programeve dhe pajisjeve, furnizimi me softëare dhe përditësimi i tyre.”.

Nëpërmjet Njoftim Vlerësimit nr. __, dt.20.01.2022 pala paditëse është njoftuar për gjobën për mospagimin e kësteve të tatim fitimit sipas nenit 114/1 të ligjit 9920/2008 në vlerën prej X lekë. Për këtë Njoftim Vlerësim duke mos qënë dakort pala paditëse e ka kundërshtuar në DAT, ku DAT me vendimin nr. __, dt.29.06.2022 ka vendosur rrëzimin e ankimit.

Gjoha prej X lekë është vendosur në bazë të nenit 114/1 të ligjit 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për mospagimin në afat të kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin:

Duke qënë se pala paditëse nuk ka patur të paguara muajt prill-maj 2021 për sa i përket kësteve të tatim fitimit atëherë pagesat që ka bërë subjekti kanë vajtur për detyrimet më të hershme që ka patur. Si pasojë muajt tetor-dhjetor 2021 rezultojnë të papaguara.

Sipas të dhënave në sistemin C@TS, konstatohet se për periudhën Tetor-Dhjetor 2021, shoqëria ka një ngarkesë kësti tatim fitimi në vlerën totale X lekë të ndara sipas muajve:

Tetor 2021	Nëntor 2021	Dhjetor 2021
X lekë	Y lekë	Z lekë

Tatimpaguesi ka të papaguar këstet e tatim fitimit paraprak për periudhën Tetor-Dhjetor 2021, deri në datën 30.12.2021. Sa më sipër është vendosur penaliteti në shumën (X lekë). Lidhur me pretendimin se pagesat për këstet e Tatim Fitimit paraprak Tetor-Dhjetor 2021 janë paguar nga tatimpaguesi brenda afatit ligjor dhe më tepër se janë përcaktuar në sistem, referuar pagesave/kompensimeve të kryera për këstet e Tatim Fitimit viti 2021, si dhe të dhënave të sistemit tatimor C@TS, konstatohet se pagesat e kryera kanë kaluar për mbulimin e detyrimeve të tjera të periudhës (Prill-Maj 2021), sipas radhës së pagesës së detyrimeve, referuar dispozitës ligjore neni 79

“Radha e pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore” të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, ndryshuar. Nga të dhënat në sistemin tatimor C@TS tatimpaguesi rezulton me këste për periudhat Tetor-Dhjetor 2021 në shumën totale X Lekë/muaj) të cilat rezultojnë të papaguara deri në datë 30.12.2021. Për rrjedhojë, për shumën e kësteve të papaguar në afat tatimpaguesi me të drejtë është penalizuar me gjobë bazuar në nenin 114/1 të Ligjit Nr.9920/2008, i ndryshuar.

Vendim i Gjykatës:

-Rrëzimin e kërkesëpadisë së palës paditëse shoqëria “E” shpk si të pabazuar në ligj dhe në prova;
-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.

4. Vendim Nr.2906, Date 24.10.2022

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

Padites : Shoqëria “M”shpk

I paditur: Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane

Objekti: 1-Shfuqizimin e aktit administrative vendim nr.__ prot., dt.12.09.2022 të Drejtorisë së Apelit Tatimor

2-Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi tatimor nr.___, dt.__.__.__ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Baza Ligjore :

5. Neni 17, neni 30 I ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
6. Neni 1327/b, neni 329 të K.Pr.Civile
7. Neni 109 i ligjit nr.9920, dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
8. Neni 116, pika 1 dhe neni 117 i Kodit Procedurës Administrative.

Permbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria “M”shpk ka paraqitur para Gjykatës një kërkesë me objekt “Shfuqizimin e aktit administrative vendim nr.1133/4 prot., dt.12.09.2022 të Drejtorisë së Apelit Tatimor he shfuqizimin e aktit administrative njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.___, dt.___ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Së pari njoftim vlerësimi objekt kundërshtimi nuk është saktësuar se për cilin njoftim vlerësim bëhet fjalë. Së dyti pala paditëse nuk ia ka vënë në dispozicion njoftim vlerësimin që po kundërshton. Si pasojë pala paditëse në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar nuk i ka paraqitur aktet që kundërshton në formën e kërkuar nga ligji për gjykatën (original ose të njësuar me origjinalin) dhe kopjet për palët e paditura dhe avokaturën e shtetit.

Vendim i Gjykatës:

- *Kthimin e kërkesëpadisë dhe të akteve që i përkasin çështjes administrative me palë paditëse shoqërinë “M” shpk.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

5. Vendim Nr.291 Datë 14.09.2022

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës : Shoqëria “H.D” sh.p.k

Të paditur : Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër;
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti : “Shfuqizimi i pjesshëm i aktit njoftim- vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ Prot., datë 10.08.2015, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe shfuqizim i vendimit nr.____, datë 25.11.2015, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor”.

Baza ligjore : Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 122, pika 1, gërma (b/i), neni 119, pika 1, gërma (a), Ligji nr.9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.23, datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit :

Shoqëria “H.D” sh.p.k është subjekt në administrim të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt aktiviteti “bar – restorant”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër i ka komunikuar subjektit njoftim-vlerësimin nr.____Prot., datë 10.08.2015, sipas të cilit subjekti është penalizuar me gjobë për punonjës të padeklaruar në vlerën 500.000 lekë dhe për moslëshim të kuponit tatimor gjatë ofrimit të shërbimit në vlerën totale 400 000 lekë.

Subjekti duke mos qenë dakord me këtë vlerësim i është drejtuar Drejtorisë së Apelimit Tatimor, me një kërkesë ankimore në lidhje me të.

Kjo Drejtori nëpërmjet Vendimit të komunikuar subjektit dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër me shkresën nr.____Prot., datë 25.11.2015, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të aktit administrativ, njoftim vlerësimit të nxjerrë nga D.R.T Shkodër për gjobën e moslëshimit të kuponit tatimor në shumën 200.000 lekë dhe gjobën për mosdeklarim të një punonjësi në masën 500 000 lekë.*
- *Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimit të nxjerrë nga D.R.T Shkodër për gjobën e moslëshimit të kuponit tatimor në masën 200.000 lekë.*

Grupi i punës së kontrollit tatimor, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, në bazë të Urdhrit të punës nr.____Prot., datë 01.08.2015, ka ushtruar kontroll në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të subjektit Shoqëria “H.D” sh.p.k dhe ka mbajtur Akt konstatimin me numër serie _____, datë 01.08.2015.

Në Akt konstatim është pasqyruar gjendja e konstatuar në fakt në momentin e kontrollit.

Në vijim nga grupi i kontrollit tatimor është mbajtur Procesverbali i gjobës me numër serie _____, datë 01.08.2015, sipas të cilit subjekti është sanksionuar me gjobë për moslëshim të kuponit tatimor gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në ofrimin e shërbimit, bazuar në nenin 122, pika 1, gërma (b; i) të

Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Procesverballi i gjobës me numër serie _____, datë 01.08.2015, sipas të cilit subjekti është sanksionuar me një gjobë në vlerën 500.000 lekë për punonjës të padeklaruar para organit tatimor.

Arsyetimi ligjor i Gjykatës :

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në lidhje me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.____, datë 17.06.2016, sipas të cilit vendosi :

- *Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë.*
- *Shfuqizimin e pjesshëm të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ Prot., datë 10.08.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe të vendimit nr.____ Prot., datë 25.11.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor, përsa i përket masës së gjobës 500.000 lekë, për mosdeklarim punonjësi, neni 119/pika 1, a, të ligjit 9920/2008.*
- *Lënien në fuqi të gjobës 200.000 lekë, për moslëshim kuponit tatimor, neni 122 pika 1/germa “b”.*
- *Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë...*

Gjykata me vendimin e saj, nëpërmjet të cilit vendos shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ objekt gjykimi, gjobën në vlerën 500 000 lekë arsyeton me argumentin, se në Akt konstatimin e mbajtur nga grupi i punës së kontrollit tatimor nuk janë evidentuar numrat e kartës së identitetit të personave të gjendur në punë, pra të dhënat personale të punonjësve për t'i identifikuar.

Gjykata i konsideron pjesërisht të ligjshme aktet administrative nr.____ Prot., datë 10.08.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe vendimit nr.____, datë 25.11.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor dhe përfundimisht vendos për pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë.

Mbi bazën e ankimimit të palës paditëse dhe palës së paditur çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila e vlerëson të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin e arritur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër për pranimin e pjesshëm të padisë.

Nga rrethanat e vërtetuara në gjykim ka rezultuar e provuar, se gjatë kontrollit të kryer nga administrata tatimore në vendin e ushtrimit të aktivitetit tregtar të palës paditëse, dy tavolina nuk kanë patur kuponin tatimor për shërbimin e kryer dhe se pretendimi i paditësit edhe në ankim që në momentin e kontrollit në këto tavolina nuk kishte njerëz por kishin mbetur vetëm filxhanët pa larguar ka mbetur në nivel deklarativ, i paprovuar. Ndërkohë rezultoi, që Akti i konstatimit i përpiluar nga inspektorët tatimore përshkruan rregullisht këtë konstatim dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i subjektit. Ndërsa sa i takon shfuqizimit të aktit administrativ objekt gjykimi për penalizimin për punonjës të padeklaruar me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar, se Akt konstatimi në përshkrimin e pjesës tek punonjësit e gjetur në punë nuk ka të shënuar për asnjërin prej tyre numrin e kartës së ID-së për të identifikuar punonjësit, element thelbësor për identifikimin e personit. Përpos analizës ligjore që ka bërë gjykata e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit në këtë zgjidhje ligjore i referohet edhe vendimit nr.33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

Ndaj këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit nuk lejohet rekurs, pasi vlera e padisë është nën kufirin minimal të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit nr.49/2012.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.____, datë 17.06.2016, të Gjykatës Administrative*

të Shkallës së Parë Shkodër.

6. Vendim Nr.374, datë 19.10.2022

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: “Z.K” shpk

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

Objekti: Pavlefshmëri Absolute të Vendimit të DAT Nr.____ Dt.04.06.2014 dhe Njoftim Vlerësimit Nr.____ Prot Dt.19.02.2014.

Baza Ligjore :

Nenet 31, 32, 35, 36 e vijues i KPC, nenet 116, 117 të KPA, nenet 69, 71, 72, 80, 81, 83, 84, 106, 107, 109 e vijues të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH.”, i ndryshuar.

Përmbledhje e Fakteve:

Pala paditese ushtron veprimtarinë si subjekt i të drejtës tregtare shqiptare, me formë organizimi “shpk”. Nga ana e inspektorëve të Kontrollit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës është ushtruar kontroll, bazuar në Lajmërimin e Kontrollit dhe Programit të Kontrollit Dt.29.03.2013, duke përcaktuar dhe periudhat dhe llojin e tatimit për të cilin do të ushtrohet kontrolli tatimor. Në përfundim të kontrollit të ushtruar, DRT Durrës ka informuar tatimpaguesin fillimisht për Projekt Raport Kontrollit, dhe brenda afateve ligjore, ka nxjerre raport kontrollin përfundimtar si dhe Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Nr.____ prot Dt.19.02.2014, në të cilin janë perlllogaritur Detyrimet tatimore, gjopa dhe kamatvonesa në shumën X leke.

Tatimpaguesi pasi është njohur me Raport Kontrollin, e ka ankimuar atë në Drejtorinë e Apelit Tatimor, organ ky i cili nëpërmjet vendimit Nr.____ Prot., Dt.04.06.2014, ka vendosur refuzimin e ankimit të palës paditëse, pasi nuk është paguar detyrimi tatimor, objekt ankimi.

Nga ana e palës paditëse, është paraqitur Kërkesepadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me objekt pavlefshmëri absolute e Akteve Administrative, Gjykatë kjo e cila nëpërmjet vendimit Nr. ____ Dt.18.09.2014, ka vendosur Rrëzimin e padisë.

Nga ana e Palës Paditese është paraqitur Ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, duke pretenduar se nga ana e Administratës Tatimore, procedura e kontrollit tatimor është kryer në shkelje flagrante me parashikimet ligjore.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, gjatë argumentimit të bërë në lidhje me këtë ceshtje, ka konkluduar se Vendimi i Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Durrës dhe për pasojë dhe akti administrativ i DRT Durrës, janë konform parashikimeve ligjore dhe zbatimit korrekt të ligjit material dhe atij procedural. Nga ana e palës paditese, pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve administrative, por nga ana tjetër nuk paraqitet asnjë argument ligjor që të legjitimojë këtë pretendim.

Për më shumë, referuar dhe jurisprudences së deritanishme, në të gjitha rastet kur nga ana e palës paditëse, pretendohet pavlefshmeria absolute, Gjykata limitohet në verifikimin vetëm të elementeve të kësaj pavlefshmerie që lidhen me kompetencën e organit, formën e aktit si dhe respektimin e procedurës së nxjerrjes së tij dhe pa marrë në konsideratë, pretendimet të cilat lidhen me elemente të pavlefshmërisë relative të aktit administrativ, të cilat mund të jenë ngritur nga ana e palës paditëse.

Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit:

-Lënie në Fuqi të Vendimit nr. _____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

7. Vendim Nr. 434, datë 26.10.2022

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: A.H. sha

I paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Objekti: *Shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi” me nr. ____prot., datë 30.08.2013 i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, në faqen 23 të tij, për sa lidhet me zërin “shpenzime shërbime dhe këshillim profesional” për këshillime mjekësore të mjekëve të jashtëm të cilët vijnë me listë çdo muaj, shpenzime të evidentuara nga administrata tatimore si shpenzime të panjohura dhe detyrimin e palës paditëse për të paguar tatim fitimin për këto shpenzime të bëra dhe të panjohura për administratën tatimore.*

Baza ligjore:

9. Ligji nr. 9920, datë.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 53, pika 1, bazuar në VKM nr. 1058, datë 21.10.2009;
10. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar;
11. Ligji nr. 92/2014 “Per tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria A.H. sha është nën administrimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Ndaj kësaj shoqërie është ushtruar kontroll, për të cilën kjo shoqëri është njoftuar me shkresën nr. ____prot., datë 14.06.2013 “Njoftim Kontrolli Tatimor”.

Gjatë kontrollit të ushtruar për shpenzimet e evidentuara në llogaritë e shpenzimeve dhe verifikimit të tyre me faturat rezultoi se shoqëria i ka kontabilizuar konform ligjit.

Në zërin e shpenzimeve dhe shërbime dhe këshillime profesionale rezulton një shumë prej xx lekë, e cila vjen nga këshillimet mjekësore të mjekëve të jashtëm të cilët vijnë me listë çdo muaj dhe nuk pasqyrohen me faturë të rregulltë tatimore, për këtë arsye shpenzimi për shumën e sipërcituar, vlerësohet si i panjohur në raport kontrollin tatimor.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit arsyeton se pala paditëse shoqëria A.H. sha në deklarinimin e shpenzimeve të saj për efekt të llogaritjes se tatim fitimit ka vepruar në përputhje me nenin 53, të Ligjit nr. 9920/2008 dhe me pikën 53/1, të Udhëzimit nr.24. datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave. Shërbimi i referuar në rastin konkret nga mjekët nuk përfshihet në gamën e shërbimeve mjekësore,

por janë thjesht rekomandime dhe ofruesit e këtyre rekomandimeve nuk janë të regjistruar sipas Ligjit nr.9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqërit tregtare”, i ndryshuar, me ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, dhe sipas nenit 40 të Ligjit nr.9920/2008, i ndryshuar. Ndryshe nga sa arsyetohet DTM dhe DAT, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, pagesat e kryera nga pala paditëse janë bërë për shërbime të njohura dhe të zbritshme për efekt të Tatimit Fitmit të shoqërisë, konkretisht, pala paditëse për shërbimin konkret të marrë nga personat e peregjistruar ka kryer pagesën pasi ka lëshuar faturën tatimore përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, pagesat janë kryer nëpërmjet sistemit bankar në Republikën e Shqipërisë.

Tatimi në burim i të gjithë pagesave të mësipërme është paguar në kohë dhe në përputhje të plotë me ligjin nr. 8438/1998, i ndryshuar. Shpenzimet e kryera nga paditësi për shërbimet e marra sipas këtij ligji, janë shpenzime të njohura dhe të zbritshme.

Pala paditëse për shërbimet e marra ka vepruar në përputhje me nenin 53, të ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar, dhe nenin 53, pika 1, të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke lëshuar fatura tatimore për shërbimet e marra nga personat e peregjistruar me gjithë informacionet e nevojshme dhe të kërkuara.

Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Lënie në fuqi të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë (nëpërmjet të cilit është pranuar kërkesëpadia e shoqërisë për shfuqizim akti administrativ).*

8. Vendim nr. 368, datë 12.10.2022

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: C. Albania sh.p.k

Të paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj
Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekt: Shfuqizimin e njoftim vlerësimit nr. _____, datë 01.11.2019 dhe shfuqizimin e vendimit nr. _____, datë 03.03.2020.

Baza ligjore:

- Nenet 32, 153 e vijues te K.Pr.Civile;
- Nenet 109 e vijues të K.Pr.Administrative;
- Nenet 7/a, 15/a e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”;
- Nenet 109/2 e vijues të ligjit nr. 9920/2008;
- Udhëzimi nr. 24/2008;
- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Nga kontrolli i dokumentacionit dhe pasqyrave financiare të bilancit të vitit 2016, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, lidhur me shpenzimet e njohura nga shoqëria si të zbritshme, u konstatuan parregullsi në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe Udhëzimit të MF Nr. 5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, si më poshtë:

Në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit 2016, llogaria 61890 “Komisione Memaxhimi & Royalty”, janë pasqyruar shpenzime për shërbime mbi politikën e çmimeve, skedulimin e produkteve, shërbime tregtare që përfshijnë aksesin në gjithë asortimentin e C.Adriatico Srl, përfshirë linjat e markës C. Natura, Bio, Saponi&Dintorni, Senza glutine-Kids, etj., sipas kontratës së lidhur në mes palëve, datë 18.12.2014, në shumën xx lekë. Deklarimi i shpenzimeve në bilanc është kryer vetëm me fletë kontabël, pa faturë tatimore.

Këto shpenzime janë pasqyruar në bilanc si të zbritshme pa faturë tatimore, kjo në kundërshtim me nenin 20, 21 pika 1 germa l) të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe pika 3.5 germa d) dhe 3.6 te Udhëzimit te MF Nr.5 datë 30.01.2006.

Në bazë të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi te Ardhurat”, i ndryshuar, neni 19 dhe 28, si dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, për shoqërinë C. Albania Shpk për vitin 2016, vendosen detyrimet për Tatim Fitimin dhe gjobë për mos pagesë, si më poshtë:

Detyrim Tatim Fitimi xx lekë

Gjobë

xx lekë

Në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit 2017, llogaria 61890 “Komisione Memaxhimi & Royalty”, janë pasqyruar shpenzime për shërbime mbi politikën e çmimeve, skedulimin e produkteve, shërbime tregtare që përfshijnë aksesin në gjithë asortimentin e C. Adriatico Srl, përfshirë linjat e markës C. Natura, Bio, Saponi & Dintorni, Senza glutine-Kids, etj., sipas kontratës së lidhur në mes palëve, datë 18.12.2014, në shumën xx lekë. Deklarimi i shpenzimeve në bilanc është kryer vetëm me fletë kontabel, pa faturë tatimore.

Këto shpenzime janë pasqyruar në bilanc si të zbritshme pa faturë tatimore, kjo në kundërshtim me nenin 20, 21 pika 1 germa l) e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe pika 3.5 germa d) dhe 3.6 te Udhezimit te MF Nr.5, datë 30.01.2006.

Në bazë të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te Ardhurat”, i ndryshuar, neni 19 dhe 28, si dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115, për shoqërinë C. Albania Shpk për vitin 2017, vendosen detyrimet për Tatim Fitimin dhe gjobë për mos pagesë, si më poshtë:

Detyrim Tatim Fitimi xx lekë

Gjobë xx lekë

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit konstaton se në procedurën e kontrollit dhe në aktet administrative objekt gjykimi, palës paditëse, i janë ngarkuar detyrime administrative duke mos i njohur shpenzimet si të zbritshme në periudhën tatimore në të cilën janë realizuar të ardhurat. E gjithë kjo me motivin që, për këto shpenzime nuk ekziston një fature fiskale brenda dy afateve të ndryshme, por që në momentin e kontrollit këto fatura kanë qenë në shoqëri sipas të gjithave kërkesave ligjore. Gjykata vlereson se secila nga këto dy data nuk mbështeten në asnjë parashikim ligjor dhe asnjëra prej tyre nuk është e detyrueshme për tu mbajtur parasysht për efekt të pranimin të shpenzimeve të njohura si të zbritshme për periudhën tatimore. Aq më tepër që legjislacioni në fuqi nuk përmban asnjë parashikim sipas të cilit, shpenzimet e njohura të regjistruara jashtë këtyre datave, nuk njihen si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit për subjektin tatimor deklarues.

Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesëpadisë.*

9. Vendim nr. 596, datë 07.12.2022

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: G.G. (subjekt i DRT Elbasan nga viti 2016)

Të paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti: Shfuqizimin e aktit administrativ: Njoftim Vleresimit tatimor nr. ____, datë 29.03.2016, nxjerrë nga DTM per tatim fitimi (detyrim +gjobë), 2012,2013,2014,2015. Shfuqizimin e aktit administrativ Vendim i DAT nr.____, datë 01.08.2016.

Baza ligjore:

1. Kodi i Procedurave Administrative, i ndryshuar;
2. Ligji 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
3. Ligji nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
4. Ligji nr.8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi G.G është kontrolluar nga DTM dhe në përfundim të kontrollit është mbajtur njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____, datë 29.03.2016.

Shoqëria ka ankimuar pjesërisht detyrimet tatimore, si më poshtë:

Detyrim tatim fitimi dhe gjobë për periudhën 2012-2015 në shumën, xx lekë.

Detyrimet tatimore të pasqyruara në aktin e kontrollit i referohen “Kontratave të shkëmbimit” të truallit, të lidhura ndërmjet pronarëve të truallit dhe investitorit, për disa objekte të ndërtuara nga kjo shoqëri.

Vlerësimi nga inspektori është kryer në zbatim të nenit 20 të Ligjit 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” ku është përcaktuar: *“Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, njihet si shpenzim i zbritshëm edhe vlera e truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi. Metodika e përcaktimit të vlerës së truallit për m² miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe bazohet në koston minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve. Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall-sipërfaqe ndërtimi. Vlerësimi i të ardhurave për pjesën e pronarit të truallit bëhet në të njëjtën mënyrë si për pjesën e të ardhurave të realizuara nga investitori dhe ai bazohet në metodikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhur me fitimin minimal fiskal”.*

Metodika e cituar në dispozitën e mësipërme, të referon te VKM nr. 1129, datë 05.08.2008 “Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit, të vënë, nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit”, e cila përcakton se “*Vlera e truallit, për m2, të vënë, nga pronarët e truallit (tokë), në dispozicion të investitorëve të ndërtimit, për veprimtari ndërtimi, për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, përkundrejt përfitimit në natyrë të sipërfaqeve të ndërtimit, llogaritet në këtë mënyrë:*

a) *Sipërfaqja e ndërtimit, në m2, që përfitojnë pronarët e truallit përcaktohet në bazë të kontratës së shkëmbimit të pasurisë truall me ndërtesën e ngritur mbi të;*

b) *Kosto e ndërtimit, për m2, përcaktohet në bazë të kostos minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve;*

c) *Vlera e truallit, të vënë në dispozicion nga pronari, llogaritet si prodhim i kostos së ndërtimit, për m2, me pjesën e sipërfaqes së objektit, që kanë përfutur pronarët.*

Vlera e truallit (tokë), e llogaritur si më sipër, është shpenzim i zbritshëm për investitorin e objektit”

VKM 173, datë 29.03.2006 “Për miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave”, në pikën 2 përcakton se “*Kostoja minimale fiskale, për një metër katror sipërfaqe ndërtimi banese, në qytetin e Tiranës, të jetë 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, përfshirë edhe TVSH-në e llogaritur të situacionit të punimeve në ndërtim”.*

Ndërsa, për të përcaktuar vlerësimin e të ardhrave për investitorin për pjesën e pronarëve të truallit, VKM 173, në pikën 7 përcakton se “*Detyrimet tatimore, që rrjedhin nga shitja e banesave, nuk llogariten, në asnjë rast, nën çmimin minimal fiskal, të llogaritur sipas kostos minimale fiskale, të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi (për rrethet e tjera të korrigjuara me koeficientet e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi) plus elementet e veçanta, të papërfshira në koston minimale fiskale, rast pas rasti, sipas pikës 4 të këtij vendimi, plus fitimin minimal fiskal, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi”.*

Në lidhje me pretendimet e saj, shoqëria kërkoi ekspert, i cili mbajti 3 raporte vlerësimi kontabël dhe bazuar në metodikën e llogaritjes të detyrimeve tatimore, duke përfshirë në llogaritje vetëm Fitimin Minimal Fiskal për rrethin Elbasan, në përfundim të procesit nxorri një detyrim total (detyrim + gjobë) xx lekë.

Nga ana jonë u kundërshtuan në mënyrë shkresore dhe verbale mënyrat e llogaritjes së detyrimeve me argumenta ligjore dhe teknike.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, në interpretim të kuadrit ligjor ka arritur në konkluzionin se, në fazën e shkëmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi palët nuk krijojnë të ardhura dhe rrjedhimisht nuk kemi lindje të detyrimit tatimor në zërin përkatës tatim fitimi. Palët e paditura në një keqinterpretim të ligjit, kanë bërë të mundur gjenerimin e detyrimeve tatimore, të cilat vetë ligji i ka përjashtuar apo trajtuar sipas fitimit minimal fiskal, sikurse me të drejtë ka pretenduar dhe pala

paditëse në padi dhe në shkaqet e ankimit.

Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë duke shfuqizuar vlerën xx lekë dhe lënë në fuqi shumën xx lekë.

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 596, datë 07.12.22 (marrë në dhomë këshillimi) ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.____, datë 11.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e kërkesëpadiës duke shfuqizuar njoftim vleresimin nr. ____ ,datë 29.03.2016 të DTM, në vlerën totale xx lekë.

10. Vendim Nr.331, datë 05.10.2022

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: Shoqëria Tregtare S.

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

Objekti: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ njoftim vlerësimit tatimor të datës 21.01.2016, për detyrime tatimore tatim dividenti për vitin 2013 dhe 2014 dhe gjobë dividenti.

Baza ligjore:

1. Nenet 31,32,154 K.Pr. Civile
2. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008
3. Nenet 116-131 Kodi i Procedurave Administrative

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi S. me NIPT/NUIS ____ është regjistruar në organin tatimor në vitin 1996, me aktivitet tregtar agjensi udhëtarësh.

Me shkresën Nr. ____ prot, datë 03.11.2015, me lëndë “Njoftim kontrolli tatimor“ tatimpaguesi S. është njoftuar se inspektori i kontrollit tatimor, në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, do të ushtroj kontroll sipas programit të DRT Korçë me objekt kontroll i plotë për tatim fitimin e vitit 2012-2014, TVSH viti 2014 deri në maj 2015, sigurime shoqërore për vitin 2014 deri në maj 2015.

Në përfundim të kontrollit bazuar në nenet 80 e vijues të ligjit është përpiluar raporti paraprak me detyrimet përkatëse, dhe pas tij raporti përfundimtar mbi rezultatet e të cilit është emëtuar njoftim vlerësimi, përcjellë tatimpaguesit me shkresën Nr. ____ prot, datë 22.01.2016, me detyrime dividend për vitin 2013 dhe 2014 si dhe gjoba total në vlerën xx lekë.

Tatimpaguesi ka ndjekur rrugën administrative të ankimit dhe rezulton se nga Drejtoria e Apelimit Tatimor është refuzuar ankimi pasi tatimpaguesi nuk kishte parapaguar detyrimet dhe kamatëvonesat objekt ankimi. Paditësi pas ezaurimit të rekursit administrativ, i është drejtuar gjykatës dhe pretendoi se nga DRT Korçë se ka shkelje proceduriale përse i përket raportit të kontrollit, shkelje që vijnë në kundërshtim me nenet 83, 84 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008. Paditësi pretendoi se shkeljet proceduriale e bëjnë aktin administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me Vendimin Nr. ____, datë 25.10.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata konstatoi që njoftim vlerësimi i nxjerrë nga DRT Korçë në kuptim të nenit 2 të Ligjit 49/2012, përbën akt administrativ individual pasi në të shprehet vullneti i organit publik ndaj subjektit juridik S. Gjykata bazuar në objektin e padisë dhe pretendimin e palëve ka marrë në

analizë pretendimin për pavlefshmëri absolute të aktit. Gjykata ka arritur në përfundimin se kontrolli tatimor është kryer në përputhje të plotë me procedurat ligjore dhe nuk ka asnjë shkelje thelbësore të procedurës që do të ndikonte në vlefshmërinë e njoftim vlerësimit tatimor.

Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se ankimi i paditësit shoqëria tregëtare S. nuk përbën shkaqe që motivojnë cënimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata arsyeton që një akt administrativ të jetë absolutisht i pavlefshëm duhet që shkelja procedurale të jetë e asaj shkalle dhe rëndësie që të ketë ndikuar në vullnetin e organit të administratës në nxjerrjen e aktit. Kjo do të thotë që, jo çdo shkelje procedurale në nxjerrjen e aktit, e bën aktin administrativ të pavlefshëm.

Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.*

11. Vendim Nr. 306, datë 21.09.2022

Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: A.O.

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë,
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti:

- Shfuqizimin e njoftim vleresimit tatimor Nr. ____ prot, datë 03.11.2015 të lënë në fuqi me vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor Nr. ____, datë 02.03.2016;
- Fshirjen nga regjistrat e DRT Korçë të gjitha detyrimet e njoftuara me njoftim vlerësimit;
- Sistemimin e deklaratave të TVSH per muajt shtator, tetor, nentor 2014.

Baza ligjore:

1. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji Nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
3. Ligji nr. 92/2014 datë 24.7.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar;
4. Neni 108-114 Kodi Procedurave Administrative.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi person fizik A.O. është regjistruar në DRT Korçë me aktivitet tregëtar “fabrikim i produkteve të qumështit”.

Me shkresën Nr. ____ prot, datë 31.07.2016, me lëndë “Kërkim informacioni”, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, në zbatim të nenit 60 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, ka kërkuar informacion nga tatimpaguesi në lidhje me aplikimin e skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësor, e cila rezulton të mos jetë aplikuar në përputhje me udhëzimin Nr. 19, datë 3.11.2014.

Nga inspektori i Drejtorisë së Vlerësimit dhe Përpunimit të të Ardhurave, në datën 02.09.2015 është mbajtur proces verbal, protokolluar me Nr. ____ prot, datë 03.09.2015, në lidhje me deklaratimet e blerjeve të kryera nga tatimpaguesi në periudhën shtator deri në nëntor 2014. Ka rezultuar se tatimpaguesi nuk ka deklaruar NIPT-et e fermerëve ku ka kryer blerjet në kundërshtim me nenin 147, pika ç e ligjit Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Inspektori ka konstatuar gjithashtu se, tatimpaguesi A.O. për periudhën dhjetor 2014 deri në Maj 2015, nuk ka njoftuar organet tatimore për aktmarrëveshjet e lidhura me fermerët.

Inspektori ka kryer llogaritjet dhe ka nxjerrë njoftim vlerësimit tatimor Nr. ____, datë 03.11.2015 me detyrime për TVSH në shumën xx lekë dhe gjjobat xx lekë.

Tatimpaguesi kundërshtoi njoftim vlerësimit tatimor në Drejtorinë e Apelimit Tatimor dhe me Vendimin Nr. ____, datë 02.03.2016 është vendosur lënia në fuqi e aktit administrativ. Paditësi i është drejtuar gjykatës, me objekt si më lart cituar.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me Vendimin Nr. ____, datë 05.12.2016, vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata ka vlerësuar se akti administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore është një akt administrativ i ligjshëm dhe i vlefshëm. Paditësi A.O. nuk rezulton të ketë njoftuar paraprakisht DRT Korçë që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit përpara se të fillojë të aplikoj skemën e kompensimit. Mosnjoftimi në kohë nga pala paditëse për palën e paditur dhe mosaplikimi korrekt sipas kësaj procedure i heq paditësit të drejtën e zbritjes së TVSH-së.

Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se ankimi i paditësit A.O. nuk përbën shkaqe që motivojnë çënimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata ka evidentuar se ligjvënësi i ka kushtuar një rëndësi të veçantë skemës së kompensimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari bujqësore.

Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit:

- *Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.*

12. Vendim Nr.472, datë 06.07.2022

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë

Paditës: Shoqëria: U KONSTRUKSION” sh.p.k

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë

Objekti:

1-Shfuqizim tërësisht i akteve administrative, “Njoftim Vlerësimi” për detyrimet tatimore nr. __ prot., datë 26.11.2021 dhe nr. __ prot., datë 26.11.2021 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe vendimit nr. __ Prot., datë 25.03.2022, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, si akte të disponuara në kundërshtim me ligjin.

2-Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tyre.

Baza Ligjore : Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi “U KONSTRUKSION” sh.p.k i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadinë me objekt:

1-Shfuqizim tërësisht i akteve administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. __ Prot., datë 26.11.2021 dhe nr. __ Prot datë 26.11.2021 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe vendimit nr. __ prot., datë 25.03.2022 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, si akte të disponuara në kundërshtim me ligjin.

2-Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të tyre.

Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë ka qenë subjekt kontrolli nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të cilët kanë kontrolluar funksionimin dhe zbatimin e detyrave funksionale të DRT Sarandë. Një ndër pikat e programit të kontrollit ka qënë verifikimi i situatës të subjekteve të cilët nuk kanë kryer pagesën e kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin. Në përfundim të auditimit të kryer, grupi i kontrollit, me shkresën nr. __ Prot., datë 28.10.2021, ka komunikuar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë raportin përfundimtar të auditimit, i cili ndër të tjera, përmban rekomandime për nxjerrjen e gjobave për tatimpaguesit të cilët nuk kanë paguar në afat këstet e tatimit mbi fitimin.

Në zbatim të rekomandimit të lënë në raportin përfundimtar të auditimit nga ana e DRT Sarandë është vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore duke nxjerrë “Njoftim Vlerësimin” nr. __ Prot., datë 26.11.2021 për gjobën në shumën X lekë për mospagim në afat të kësteve të tatim fitimin për vitin 2018 dhe Njoftim Vlerësimin nr. __ Prot., datë 26.11.2021 për gjobën në shumën X lekë për mospagim në afat të kësteve të tatimit mbi fitimin për vitin 2019, për tatimpaguesin “U KONSTRUKSION” sh.p.k.

Detyrimi ligjor për parapagimin e kësteve të tatim fitimit lind nga dispozitat ligjore të Ligjit 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 29 dhe 30 i tij si dhe Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006 pika 3.12 dhe 3.13 e këtij udhëzimi. Penaliteti i vendosur për mospagim në afat të kësteve të tatim fitimit është bërë bazuar në nenin 114/1 të Ligjit 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

Tatimpaguesi “U KONSTRUKSION” sh.p.k, pasi është njoftuar me këto akte administrative ka ndjekur rrugën e ankimit administrative pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor ndaj Njoftim Vlerësimeve të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë. Drejtoria e Apelit Tatimor pasi ka marrë në shqyrtim këtë ankim me vendimin e saj nr. ___prot., datë 25.03.2022, ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrative, Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. --- prot datë 26.11.2021, gjobë për mospagim në afat kësti në shumën X lekë për vitin 2018.*

Lënien në fuqi të aktit administrative, “Njoftim Vlerësimi” për detyrimet tatimore nr. ___ prot., datë 26.11.2021, gjobë për mospagim në afat kësti në shumën X lekë për vitin 2019.

Duke mos qenë dakord me këtë vendimarrje, tatimpaguesi ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor ndaj akteve administrative pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrative “Njoftim Vlerësimi” për detyrimet tatimore nr. ___prot datë 26.11.2022, Njoftim Vlerësimi nr. ___ prot datë 26.11.2021 të nxjerrë nga DRT Sarandë dhe vendimit nr. ___ prot datë 25.03.2022 të DAT-së.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, çmon se veprimtaria e inspektorëve të palës së paditur, rregullohet ndër të tjera nga ligji 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet procedura e detyruar ligjore që inspektori që kryen inspektimin duhet të ndjekë në konstatimin dhe ndëshkimin e kundravajtësit që kryen kundravajtjen administrative në fushën e tatimeve.

Ndjekja e procedurës ligjore të konstatimit dhe ndëshkimit të kundravajtjes administrative, të përcaktuara në dispozitat ligjore të mësipërme, çojnë inspektorin që kryen inspektim në vendimarrje të drejtë ligjore dhe të pacënueshme në rrugë administrative e gjyqësore.

Kundravajtja administrative cilësohet si e konsumuar kur në kuptim të anës objektive, subjekti kundravajtës ndërmerr veprime në kundërshtim me ligjin ose nuk vepron në përputhje me urdhërimet ligjore dhe në drejtim të anës subjektive këto veprime e mosveprime kryen me faj.

Gjykata çmon se ligjvënësi në dispozitat ligjore të Ligjit 8438/1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 30 dhe pikës 3.13 të Udhëzimit nr.5 datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, kanë përcaktuar qartë detyrimin që kanë tatimpaguesit për të parapaguar këstet e tatimit mbi fitimin.

Mbi bazën e provave shkresore të administruara dhe pohimeve të palëve ndërgjyqëse u provua se pala paditëse tatimpaguesi “U KONSTRUKSION” sh.p.k, për vitet 2018 dhe 2019 nuk ka paguar në afat këstet e tatim fitimit dhe me të drejtë Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë ka nxjerrë aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor.

Në seancë gjyqësore u provua se pala paditëse ka kryer kundravajtjen administrative të parashikuar nga neni 114/1 “Mospagim i kësteve të tatimit mbi fitimin dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin”, të Ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, Gjykata i çmon të drejta dhe të bazuara në ligj veprimet administrative të kryera nga organi tatimor të përshkruara në pjesën e pretendimeve të palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë. Veprimet e saj janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata në analizë të provave shkresore dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se pretendimet e paditësit janë të pambështetura në ligj dhe në prova dhe si të tillë ato nuk duhet të pranohen.

Përsa i përket kërkimit të paditësit për pavlefshmëri absolute të akteve administrative, Gjykata vlerëson se ky kërkim i paditësit është i pabazuar në ligj dhe për këtë fakt ai duhet të rrëzohet.

Gjykata çmon se kërkesëpadia e palës paditëse duhet të rrëzohet, pasi nuk u provua ekzistenca e

elementëve të paligjshmërisë së akteve administrative, referuar parashikimeve të dispozitave ligjore në fuqi, konkretisht neni 108 e 109 të K.Pr.Administrative.

Vendimi i Gjykatës:

- Rrëzimin e kërkesëpadisë.